

BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KOPSHTIT ZOOLOGJIK
TITULLARI AUTORITETIT KONTRAKTOR

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, _____, 2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: ” Blerje pajisje për kujdesin e kafshëve”

Numri i referencës së procedurës/Lotit (eve): REF-64769-10-14-2025

Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 39300000-5 – Pajisje te ndryshme

VLERA E FONDIT LIMIT: 6 590 562 (gjashtë milion e pesëqind e nentëdhjetë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e dy) Lekë pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Drejtorja e Përgjithshme e Kopshtit Zoologjik, Bashkia Tiranë**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 4;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë “Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është kërkuar kjo me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të kenë Autorizim për tregtim të pajisjeve mjekësore”, të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë, sipas Ligjit 89/2014 “Për pajisjet mjekësore”.

Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës, pra të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, ndërsa kushti që bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar është vendosur në zbatim të nenit 41, të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”i ndryshuar.

2.2.2 Xhiroja vjetore e operatorit ekonomik ofertues gjatë 3(tre) viteve të fundit (2022, 2023, 2024) të jetë jo më **pak se 40% e vlerës së fondit limit** dhe kjo të jetë e vërtetuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore me shkresë ose me dokument të nxjerrë online me vulë elektronike. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës. Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të mos ketë detyrime për taksat vendore për **Vitin 2025 (ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas Ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore", i ndryshuar), duke paraqitur një vërtetim nga organet e qeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin. Në rast bashkimi operatorësh ekonomikë, vërtetimin nga organet e qeverisjes vendore duhet ta ketë secili subjekt më vete.**

Shënim: Ky kriter (2.2.3) do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur operatori ekonomik ofertues renditet i pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohej sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore" i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2021 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për "Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t'iu nënshtruar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale:

2.3.1 Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë prej 20% të vlerës së fondit limit/ vlerës së pritshme të kontratave, të lotit apo shumës së loteve për të cilat konkurron, të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës të kësaj procedure prokurimi.

Si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkohej vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave

të legjislationit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” në kushtet kur kjo procedurë prokurimi klasifikohet procedurë e hapur e thjeshtuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20% të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Në zbatim të nenit 55, pika 4/b në kushtet kur kjo procedurë prokurimi është procedurë e thjeshtuar të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.3.2 Auto-deklarate për origjinën e mallit, ku te përcaktohet vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese (te plotësohet dhe ne shtojcën 1 – oferta ekonomike).

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri AK gjykon se deklarata e furnizimit ose autorizimi i prodhuesit /distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të cilat kërkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kërkuara në DST. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë alternative (do të konsiderohen të barazvlefshme dhe deklaratat me shkrim të furnizimit dhe autorizimi i prodhuesit) i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.3 OE duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi ose distributor i autorizuar prej prodhuesit (ku të provohet/dokumentohet lidhja e tyre me prodhuesin) për artikujt me nr rendor nga 2-8 , nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë pajisjet objekt i kësaj procedure prokurimi. Autorizimi duhet të jetë origjinal ose kopje e përkthyer dhe noterizuar.

Argumentimi: Në bazë të nenit 77 të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe pikën 8, të nenit 40, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me anë të këtij kriteri AK gjykon se deklarata e furnizimit ose autorizimi i prodhuesit /distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave objekt prokurimi të

cilat kërkohen që të jenë prodhuar në përputhje me standardet dhe cilësitë e kërkuara në DST. Ky kriter është në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë alternative (do të konsiderohen të barazvlefshme dhe deklaratat me shkrim të furnizimit dhe autorizimi i prodhuesit) i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.4 Operatori ekonomik, duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE, FDA ose ekuivalent, të vlefshme, për të gjithë artikujt me nr. Rendor 2-8 , të përkthyer dhe të noterizuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar.

Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit.

1.3.5 Operatori ekonomik duhet të jetë i certifikuar ISO 9001:2015 për import, eksport, tregetim të pajisjeve mjekësore /ose/ ekuivalent. Për këtë ai duhet të paraqesë certifikatën përkatëse, të vlefshme. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është kërkuar kjo certifikatë me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar për import, eksport, tregetim të pajisjeve mjekësore /ose/ ekuivalent. Çertifikata duhet të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Nisur nga rëndësia, volumi i kontratës, rëndësia e AK (Autoritetit kontraktor) të përfshirë në këtë procedurë është e rëndësishme me qëllim realizimin me sukses të kësaj procedurë që operatori pjesëmarrës të provojnë të demonstrojnë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte që plotësojnë kërkesat e konsumatorëve pra të AK-së dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullative me qëllim të rrisë kënaqësinë e konsumatorit nëpërmjet zbatimit efektiv të sistemit.

2.3.6 Për të gjithë artikujt e kërkuar sipas tabelës së pasqyruar në këto Dokumente Tenderi (*Specifikimet teknike*) të paraqiten katalogë, ku të përfshihen edhe specifikimet teknike të

hollësishme për secilin artikull *(pjesët e katalogut që përmbajnë emërtimin dhe specifikimet e detajuara teknike të artikullit që ofertohej, nëse nuk janë në gjuhën shqipe, të përkthehen në gjuhën shqipe dhe të noterizohen)*. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalogun përkatës produktet që ofron sipas numrit rendor **(te markuara sipas artikullit)** të përcaktuar në formularin e ofertës. Katalogët do pranohen vetëm në formë elektronike nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të cilat janë të domosdoshme në realizimin e shërbimeve objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi kemi të bëjmë me mjete profesionale të cilat domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin për vet natyrën që kanë.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën e garancisë për pajisjet dhe aksesoret shoqërues (nëse aplikohet), në të cilën duhet të saktësojë se periudha e garancisë për çdo defekt të mundshëm teknologjik është për të paktën 1 (një) vit duke filluar nga data e furnizimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër periudhën e garancisë për mallrat e prokuruar. Kjo deklaratë shërben si garanci për Autoritetin Kontraktor që malli i lëvruar është në përputhje me specifikimet teknike dhe në rast defekti që vjen nga prodhimi ose të cilësia të ndodhur brenda periudhës së garancisë, të kryhet zëvendësimin ose riparimi i tyre pa pagesë nga operatori ekonomik.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratën se do të trajtojë stafin për përdorimin e aparaturave/pajisjeve mjekësore objekt prokurimi sipas manualit të prodhuesit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.. Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në natyrën e objektit të prokurimit. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë për realizimin e objektit.

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të vërtetohet që ka të paktën **2(dy)* punonjës Inxhinierë/Specialistë** në stafin e vetë, të trajnuar për pajisjet objekt prokurimi të cilët do të kryejnë furnizimin dhe instalimin e pajisjeve mjekësore, të vërtetuar nëpërmjet: diplomës, certifikatës së trajnimit, CV-së, kontratës individuale të punës. Ky staf do të kryejë instalimin dhe vendosjen e aparaturave/pajisjeve mjekësore sipas kërkesave të AK.

Për këtë OE duhet të disponojë dokumentet e mëposhtme provuese për Inxhinierët/Specialistët e mësipërm:

- Diploma
- Certifikatat/dëshmitë e trajnimit për pajisjet, lëshuar nga kompania prodhuese ose ekuivalentet e këtyre certifikimeve lëshuar nga autoritete të autorizuar/certifikuara për dhënien e tyre;
- Kontratë pune/ shërbimi e vlefshme.
- Listepagesat e deklaruara ne organet tatimore (formularët E-sig 025) ne tre muajt e fundit nga data e zhvillimit te tenderit për inxhinieret bazuar në VKM nr 514 date 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare te profesioneve”.

Shënim: Ky kriter (2.3.2) do të konsiderohet i përmbushur nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për t’u kërkuar sqarime nga Autoritetit Kontraktor.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.. Ky numër minimal është kërkuar duke u bazuar në natyrën e objektit të prokurimit. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë për realizimin e objektit.

2.3.10 Operatori Ekonomik Ofertues duhet te paraqese oferten teknike, per artikujt e kerkuar ne forme tabele, ku te plotesohet: Specifikimet teknike, Emri i kompanise prodhuese, Origjina e mallit, Skadencia e mallit, Emertimi i katalogut te artikullit/ produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, Numri i references se artikullit (kodi) nxjerre nga katalogu i prodhuesit, si dhe certifikimet perkatese per produktet

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6 b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave të cilat janë të domosdoshme në realizimin e shërbimeve objekt prokurimi. Në këtë rast është shumë e rëndësishme plotësimi i specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor pasi kemi të bëjmë me mjete profesionale të cilat domosdoshmërisht duhet të garantojnë cilësinë e kërkuar dhe funksionalitetin për vet natyrën që kanë.

2.3.11 Koha e Levritimit 30-60 dite nga momenti i lidhjes së kontratës.

SHËNIM: Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (të ndryshuar), ku konkretisht në pikën 6 të nenit 26 parashikohet:.....*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.....*

Përsa më sipër, ofertuesi i kualifikuar, i pari, duhet të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor dokumentacionin, e parashikuar në pikën 6 të nenit 26, të Rr.P.P., brenda afatit 5 ditor që ka në dispozicion autoriteti kontraktor, për publikimin e njoftimit të fituesit, sipas nenit 97/1, të LPP-së.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Ligji nr.9779, datë 16.07.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”.

Specifikimet teknike të mallrave objekt prokurimi janë hartuar duke u bazuar në nevojat reale të përdorimit të mallrave objekt të prokurimit. Keto artikuj janë hartuar nga Drejtorinw e Veterinarisë dhe Mirëqenies së Kafshëve. Konkretisht, pajisjet e kërkuara do të shërbejnë për parandalimin dhe trajtimin e sëmundjeve të ndryshme për rreth 300 kafshë dhe shpendë të koleksionit tonë zoologjik dhe ngritja e këtyre kapaciteteve do të rriste efikasitetin e punës, do të ofronte shërbimin e duhur veterinar dhe plotësonte në këtë mënyrë një ndër funksionet kryesore të drejtorisë. Gjithashtu pajisjet e nevojshme për enrichment (pasurimin mjedisor) e kafshëve do të rriste jo vetëm mirëqenien e kafshëve por do të plotësonte edhe një standard të munguar për sa i përket mirëqenies dhe do të rriste cilësinë e atraksionit për vizitorët si dhe të pajisjeve të nevojshme për të siguruar që kafshët e koleksionit zoologjik të kenë një zhvillim të mirë psiko-motor.

Specifikimet teknike gjenden në shtojcën 6 të Dokumentave Standarte të Tenderit.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njësia e Prokurimit